



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

Legjislatura VI  
Sesioni pranveror

---

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike  
Mbledhja nr. 14  
Prishtinë, më 27.02.2018, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

**P r o c e s v e r b a l**

**Në mbledhje morën pjesë:** Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Aida Dërguti, Visar Ymeri, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Doruntinë Maloku-Kastrati dhe Zafir Berisha.

Në mbledhje ishte prezent për raportim, ministri i MPB-së Flamur Sefaj me bashkëpunëtorët Kastriot Muçolli e Veton Elshani.

**Munguan:** Evgjëni Thaçi-Dragusha dhe Sërgjan Mitrovic.

**Pjesëmarrësit e tjerë:** Adelina Hasani-KDI, Donika Marku, QKSS, Egnesa Vitia-praktikante dhe media.

**Nga stafi i komisionit:** Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

**Rendi i ditës:**

Raportim i ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme z. Flamur Sefaj, lidhur me procesin e aplikimit të Kosovës për anëtarësim në Interpol.

**Vjosa Osmani - Sadriu** përshëndeti gatishmërinë e ministrit z. Sefaj për të raportuar në komision, duke theksuar se, edhe pse MPJ është e përfshirë në procesin e aplikimit të Kosovës për anëtarësim në Interpol, komisioni ka shprehur interesimin të informohet nga MPB, e cila është e kyçur drejtpërdrejtë në këtë proces. Ajo tha se ne mund të ofrojmë bashkëpunimin tonë, si komision parlamentar për të ndihmuar që ky proces të jetë i përgatitur mirë dhe të mos dështoj. Kërkoj të informohet nga ministrin Sefaj, se si e ka gjetur këtë proces, çka nuk ka shkuar në rregull dhe cilat janë përgatitjet që po bëhen në këtë drejtim.

**Flamur Sefaj** vlerësoi se raportimi i ministrit të MPB pranë këtij komisioni, është i nevojshëm dhe i dobishëm në veçanti për procesin e Interpolit, por edhe për anëtarësim në organizata të tjera ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me ato. Njoftoi se çështja e anëtarësimit në Interpol, ka qenë e trajtuar në mënyrë shumë serioze nga ish ministri Hyseni, nga i cili tha se ka pranuar dosjen e materialit për këtë proces. Ai njoftoi se në shtator të vitit 2017, Kryeministri z. Haradinaj i është drejtuar me shkresë zyrtare sekretarit, kryetarit dhe anëtarëve të Komitetit ekzekutiv të Interpolit, përmes së cilës ka kërkuar shtyrjen e votimit për aplikim të Kosovës në Interpol. Në cilësi të

ministrit të MPB, në shtator tha se ka komunikuar me shkresë zyrtare me sekretarin dhe zyrën ligjore të kësaj organizate, për të ri konfirmuar shtyrjen e votimit dhe duke aprovuar dërgimin e letrës së kryeministrit tek të gjitha shtetet anëtare të Interpolit. Ministri njoftoi se është formuar grupi punues me qëllim të lobimit për anëtarësimin e Kosovës në Interpol, i cili udhëhiqet nga Majori Elshani. Njoftoi se me bashkëpunëtorët e tij kanë pasur një takim në selinë e Interpolit në Lion, ku është konfirmuar se Kosova nuk ka nevojë të ri aplikoj nga fillimi, ku edhe është kërkuar që të hiqen nga lista e kërkimit të Interpolit të gjithë shtetasit e Kosovës, të cilët kërkoheshin nga Serbia, për krime lufte përfshirë edhe Kryeministrin z. Haradinaj. Çështja e Interpolit tha se nuk është çështje e një ministrie, por çështje ndërministrore, e para së gjithash është interes nacional. Këtë çështje tha se nuk bën dhe nuk guxojmë që ta ngremë në nivel politik sepse mund të jetë e mundur, që të dështojmë. Ne dëshirojmë theksoi ai që të jemi pjesë e një organizate si pjesëtarë të barabartë me të gjithë, që të kemi qasje në informata dhe ata të kenë qasje në informata tona. Ministri njoftoi edhe për konfirmimin nga BE, se do të punohet lidhur me nënshkrimin e bashkëpunimit me Europol-in. Ai theksoi se janë duke punuar për lobim për anëtarësim në Interpol, por se ka edhe lobime të kundërta nga Serbia dhe Rusia.

**Vjosa Osmani - Sadriu**, duke e ndërlidhur me njoftimin e ministrit Sefaj se ka marrë dosjen nga ish ministri me të gjitha përgatitjet për procesin, e pyeti atë se nga ai material në votën e sa shteteve kanë mund të llogarisin. Ajo më tej tha se në të njëjtën ditë kur është planifikuar që të bëhet votimi për anëtarësim të Kosovës, është anëtarësuar Palestina dhe Ishujt Solomon. Pyeti ministrin se a është bërë vlerësimi i duhur në ditët e para të punësisë tij, për t'i bërë rekomandim kryeministrit për shtyrjen e votimit dhe pse ekziston një dallim aq i madh në mes të analizës paraprake dhe qeverisë së tanishme lidhur me numrin e shteteve përkrahëse në këtë proces, që ishte dallimi nga 80 në 40 shtete. Ajo kërkoi që ministri të sqaroj më tepër, lidhur me kërkesën për heqjen nga lista e kërkimit nga Interpoli të qytetarëve tanë, për krime lufte duke vë në pah se mund të ketë edhe aktakuza të tjera kundër zyrtarëve politik që nuk kanë qenë në luftë, por kanë qenë pjesë e politikës kundër regjimit të Millosheviqit. Në këtë drejtim tha se nëse kërkesa është kufizuar vetëm për krime lufte duhet kërkuar që kjo kërkesë të zgjerohet për të gjithë personat për të cilët mund të kenë pasur fletë arrest, nga viti 89 e këndeje. Më tej kërkoi të informohet se çfarë është bashkëpunimi në mes të grupit punues aktual dhe ish grupit punues dhe propozoi që MPB të angazhohet për lobim më tepër me shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën, në mënyrë që argumentimi të mbetet në baza profesionale.

**Flamur Sefaj** njoftoi se personalisht nuk ka pas ndonjë kalkulim të votave, por ai është bërë me të gjitha institucionet së bashku, të cilat kanë qenë të kyçura në këtë proces. Duke pasur parasysh se nuk i kemi pasur votat në UNESCO, tha se kemi bërë llogarinë se nëse Kosova nuk do të kaloj në këtë votim, kostoja do të ishte shumë më e madhe se benefiti, ndërsa llogaria në atë moment ka mund të jetë minus gjashtë vota. Kërkesa për red notice në Interpol tha se ishte bërë para se të vinte ai në detyrën e ministrit, por se ai kishte kërkuar që ajo kërkesë, të kishte një datë. Ministri njoftoi se në grupin punues, ka anëtarë të përfshirë edhe nga ata që kanë punuar më herët për anëtarësim në organizatën e Interpolit. Sa i përket sugjerimit për bashkëpunim me vendet jo njohëse të Kosovës bëri të ditur se janë duke bashkëpunuar me të gjitha shtetet, por nuk mund të jap detaje të hollësishme lidhur me këtë.

**Veton Elshani** njoftoi se në vitin 2009, ka qenë mbikëqyrës në sektorin për bashkëpunim ndërkombëtar dhe se janë marrë me organizata ndërkombëtare. Në këtë proces tha se ka qenë i involvuar, por nga viti 2015 janë involvuar shumë më tepër me ish ministrin Hyseni për të cilin tha se ka formuar një grup joformal. Në përbërjen e këtij grupi, njoftoi se ka pasur 4-5 zyrtar nga MPJ, se ai ka qenë nga Policia e Kosovës dhe zyrtarë nga MPB, por se nuk ka pasur organizim të mirëfilltë. Bëri të ditur se atëkohë nga Policia e Kosovës, z. Shpend Maxhuni i ka kontaktuar mese njëzet shtete dhe ka fituar një optimizëm kur ka filluar të marr përgjigje pozitive edhe nga shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën. Njoftoi se në takimin e parë që ka pasur me ministrin Sefaj, është pyetur nga ai, lidhur me Interpolin. Gjatë diskutimit të tij njoftoi komisionin se vështirësi kanë

pasur, meqë nuk kanë mund të llogarisin se sa vota do t'i kenë në këtë proces, por si bazë tha se kanë pasur rastin për UNESCO. Theksoi se kanë qenë të sigurt se do t'i kenë 50% të votave, por në analizë të numrave në ditën e fundit, kanë qenë minus gjashtë vota, nga 2/3 e votave të shteteve të pranishme. Z. Elshani njoftoi se tani kanë një koordinim më të mirë të grupit punues, njoftoi edhe përbërjen e tij, i cili tha se udhëhiqet nga ai, si kryesues i grupit. Në momentin që Kosova do të jetë në agjendë për votim në Interpol, tha se në grupin punues do të involvojnë edhe partnerë të tjerë si nga qeveria po ashtu edhe nga opozita nga se është e nevojshme ndihma e çdo kujt. Bëri të ditur se janë në kontakte edhe me personalitete të tjera, vendore e ndërkombëtare për këtë proces. Z. Elshani njoftoi edhe për heqjen nga lista e kërkimit të Interpolit të shtetasve kosovar, duke bërë të ditur se nuk është askush në kërkim as për krime lufte, as për terrorizëm e as për gjenocid, meqë janë larguar të gjithë nga lista.

**Flamur Sefaj**, sa i përket grupit punues njoftoi se ka mundësi që të zgjerohet dhe se kanë shqyrtuar mundësinë që të kyçen edhe anëtarë nga Kuvendi si dhe ekspertë të ndryshëm, sepse kjo konsiderohet si çështje nacionale. Lidhur me shtyrjen e aplikimit në Interpol, ministri tha se kanë munguar votat dhe se beneficioni do të ishte shumë më i vogël se sa risku dhe humbja që do ta pësonim në rast të aplikimit. Kjo ka ndodh për shkak se është politizuar çështja e aplikimit në Interpol dhe se ka munguar koordinimi në mes të MPB dhe MPJ, tha ministri. Më tej njoftoi se nuk është më ky problem dhe se kanë bashkëpunim të jashtëzakonshëm me MPJ e cila është duke lobuar në të gjitha kontinentet. Sa i përket dallimit prej 40 votave, ministri njoftoi se ky numër mund të jetë nga numri total i anëtarëve të Interpolit, pra prej 190 anëtarëve.

**Vjosa Osmani - Sadriu**, lidhur me dallimin e votave tha se Ministri i Punëve të Jashtme në raportim para komisionit ka thënë se i ka marr 22 konfirmime që i shtohen 44 konfirmimeve të mëhershme që i bie se i kanë pasur 66 konfirmime, por Kosovës i janë nevojitur 112 vota. Dështimi për t'u anëtarësuar në UNESCO tha se ka pas kosto të madhe dhe se ka dëmtuar në përgjithësi procesin e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare. Ajo shtoi se është më rëndësi që për anëtarësim në Interpol të ketë një bashkëpunim sa më të madh me të gjitha institucionet si dhe me shoqërinë civile, e cila mund të luaj një rol themelor. Ajo tha se nga konteksti i politikës së jashtme nuk mund të bëhet vlerësimi për Interpol duke u bazuar në votat e UNESCO, sepse disa shtete që kanë votuar kundër ose kanë abstenuar, arsyet e tyre nuk kanë të bëjnë me njohjen e Kosovës si shtet dhe se vlerësimi duhet të bëhet në mënyrë specifike për organizatën specifike.

**Doruntinë Maloku - Kastrati** tha se është njoftuar nga ministri Hyseni se ai iu ka dhënë shpjegimet e duhura partnereve ndërkombëtarë me të cilët është pajtuar që aplikacioni i Kosovës të mos tërhiqet për shkak se ishte në pako me Palestinën dhe Ishujt Solomon dhe shtoi se tërheqja e aplikacionit e ka vënë procesin e anëtarësimit në pikëpyetje. Ajo pyeti se sa do të arrijmë të marrim përkrahje nga radhët e shteteve që do të votojnë në favor të Kosovës në kohën kur Kosova ishte në pako me Palestinën dhe Ishujt Solomon.

**Flamur Sefaj** tha se sa i përket dallimit të votave nuk e ka pas një tabelë të specifikuar dhe pas analizave të bëra ka dalë që ka mungesë të votave. Votimi në UNESCO nuk është marrë për bazë, por ka qenë një indikacion sepse nuk ka pasur shifra të tjera njoftoi ministri. Ai tha se tash është më rëndësi që të koleksionohen votat dhe se nevojitet edhe bashkëpunimi i deputetëve në këtë drejtim.

**Zafir Berisha** tha se edhe pse Kosova ka marrëveshje me Serbinë që të mos pengohet në inkuadrimit në mekanizma ndërkombëtarë, Serbia është shumë aktive në pengimin e Kosovës, e kjo u vërejt me rastin e aplikimit të Kosovës në UNESCO dhe Interpol. Z. Berisha shprehu mendimin se, paralel me lobimin duhet t'iu bëhet e qartë shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën se prezenca e Kosovës në Interpol është edhe në interes të tyre. Duke u ndërlidhur me nevojën e inkuadrimit të Kosovës në Interpol shtoi se Kosova është pjesë e Evropës dhe se është në një rajon shumë të ndjeshëm, i cili prodhon edhe paqe, por edhe kriza. Inkuadrimi i Kosovës në organizata

ndërkombëtare tha se kërkon një kombinim të politikave, e në veçanti të politikës së jashtme në raport me Serbinë duke shtuar se BE është ndërmjetësuese e bisedimeve, dhe se Serbia duhet t'i qëndroj besnik zotimeve të bëra në takimet e deritanishme. Është edhe interesi i Serbisë që Kosova të jetë pjesë e Interpolit, mirëpo për shkak të politikave, që janë vazhdimësi e politikës gjenocide, edhe për një kohë do ta kemi këtë problem, tha z. Berisha.

**Flamur Sefaj** i njoftoi se ky proces edhe në nivel ndërkombëtar është i politizuar nga Serbia dhe se do t'i konvenonte të gjithëve nëse Kosova të jetë anëtare edhe për shkaqe operationale edhe praktike dhe se kjo nuk do ta dëmtonte askënd. Z. Sefaj po ashtu njoftoi se nuk kanë pasur viza për të qenë të pranishëm në Kinë ku është mbajtur Asambleja e Përgjithshme e Interpolit, ku edhe është planifikuar që të bëhet një vlerësim dhe pastaj të vendoset se a të vazhdohet me kandidaturën apo të kërkohet shtyrja. Sa i përket vendimit për të shtyrë aplikimin ministri tha se nuk ka qenë vendim i lehtë, se vendimi është bazuar në optimumin e mundshëm dhe se kanë mundur të rrezikojnë, por nuk kanë pas dijeni për makro politikat që kanë qenë në atë moment, pasi që nuk kanë qenë të pranishëm. Z. Sefaj i njoftoi anëtarët e komisionit se kanë pas përkrahje edhe nga miqtë ndërkombëtar, por SHBA ka qenë indiferent ndaj Kosovës për shkak të Palestinës.

**Dukagjin Gorani** kërkoi të elaborohet se pse ka pas vonesa për të aplikuar, ku në një periudhë prej 10 viteve është aplikuar vetëm 2 herë. Ai tha se periudha 2010 – 2015 e përfshin procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe pyeti nëse vonesat dhe shpërqendrimi institucional karshi kësaj çështje ndërlidhet me një qëndrim defensivë nga Qeveria e Kosovës, karshi anëtarësimit në Interpol.

**Veton Elshani** i njoftoi se në vitin 2010 MPB ka aplikuar për anëtarësim, mirëpo është refuzuar nga zyra ligjore e Interpolit, për shkak se Kosova nuk ka pas ligj dhe agjenci për mbrojtjen e të dhënave personale. Në vitin 2015 tha se zyra ligjore e Kombeve të Bashkuara e ka dhënë lejen që të lidhet një marrëveshje në mes të Kosovës dhe Interpolit dhe është rishikuar marrëveshja e bashkëpunimit e vitit 2002 e lidhur në mes të UNMIK dhe Interpol. Me rastin e aplikimit në vitin 2015, z. Elshani tha se në Asamblenë Parlamentare të Interpolit është vendos që të shtyhet aplikimi i të tri shteteve për vitin 2017 për shkak të rekomandimeve të z. Corell. Ai njoftoi se MPJ e ka pas rolin kryesor në lobim dhe se ka ekzistuar një diskrepancë në madhe, për këtë arsye i kanë rekomanduar Ministrit të Punëve të Brendshme që grupi punues t'i kontaktojë drejtpërdrejtë ambasadorët dhe jo përmes MPJ, për t'i evituar vonesat në komunikim. Ai po ashtu njoftoi se i kanë rekomanduar ministrit që të përfshihet edhe LVV, LDK dhe partitë tjera në opozitë, sepse është detyrë e secilës Qeveri, që vjen.

**Vjosa Osmani - Sadriu**, sa i përket angazhimit të spektrit politik, tha se është më mirë që kjo të bëhet në nivel institucional e jo në nivel partiak, prandaj edhe ekziston Komisioni për Punë të Jashtme ku janë të përfaqësuara të gjitha grupet parlamentare. Komisioni, njoftoi se ka shpreh gatishmëri që të jetë pjesë e të gjitha grupeve punuese për anëtarësim në organizata ndërkombëtare dhe kërkoi të njoftohet për takimin e radhës të grupit punues, ku do të merr pjesë edhe një anëtar i komisionit.

**Visar Ymeri**, duke iu referuar një interviste të Ministrit të Jashtëm z. Pacolli, i cili ndër të tjera thotë se janë bërë lëshime ndaj Serbisë dhe se tërheqja e Kosovës nga aplikimi në Interpol është një gjest që tregon se Kosova është duke i ndihmuar procesit të dialogut. Lidhur me këtë pyeti nëse kjo është e vërtetë, nëse ky diskutim është bërë në grupin punues dhe nëse ka qenë pjesë përbërëse e vendimit për ta kërkuar shtyrjen e votimit për anëtarësim në Interpol, apo z. Pacolli në këtë rast nuk po e paraqet dinamikën e diskutimit institucional, sa i përket Interpolit.

**Flamur Sefaj**, lidhur me pyetjen e deputetit Ymeri, njoftoi se gjatë bisedave me Ministrin Pacolli nuk është hapë kjo temë dhe se më të është diskutuar mbi numrat dhe arsyeja se pse nuk është proceduar më tej me këtë çështje ka qenë pikërisht mungesa e numrave. Deri tek tërheqja e

aplikimit të Kosovës në Interpol tha se kanë qenë dy arsye, e para ka qenë çështja e votave. Kurse e arsyeja e dytë ka të bëjë me atë se Kosova ishte në një listë me Palestinën.

**Vjosa Osmani - Sadriu**, tha se komisioni nuk e sheh anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare si proces politik apo partiak dhe secili deputet pavarësisht se për cilën organizatë bëhet fjalë tenton të jep një kontribut pozitiv në mënyrë që Kosova të jetë e suksesshme. Ajo tha se është e papranueshme qasja nëse Kosova bënë koncesione në procesin e aplikimit në organizata ndërkombëtare, vetëm për ta qetësuar Serbinë në procesin e dialogut dhe se për këtë nuk ka konsensus. Një prej çështjeve që është diskutuar një kohë të gjatë në procesin e dialogut njoftoi se ka qenë fakti që Serbia nuk do të duhej ta bllokonte Kosovën në procesin e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare. Ajo po e bën të kundërtën, por kjo nuk do të thotë se duhet të tërhiqemi. Kryetarja pyeti ministrin se sa është optimist që kësaj radhë votimit do të jetë i suksesshëm për Kosovën.

**Flamur Sefaj** tha se z. Pacolli e riaktivizojë procesin e njohjeve dhe se pohimi nga mediumi i përfolur është spekulativ, sepse ai ka qenë ndoshta personi i fundit që është dakorduar për ta shtyrë aplikimin. Më tej shtoi se nuk është trajtuar tema e lëshimeve, në dialog me Serbinë.

**Elmi Reçica**, tha se nga informacionet që i morën nga ministri dhe ato që i kanë pasur vërehet që kjo çështje është marrë me një seriozitet të shtuar dhe se është mirë që ekipet joformale janë zyrtarizuar. Ai shtoi se ne jemi në dijeni të rëndësisë së mekanizmave ndërkombëtarë, sidomos të atyre që e luftojnë të keqën dhe se përmes Interpolit luftohet e keqja. Edhe për Serbinë do të ishte më rëndësi që Kosova të jetë pjesë e Interpolit, si shembull mund të merret rasti i vrasjes së Oliver Ivanoviqit, ku Serbia u detyrua që forma të tjera të kërkojnë informacione prej organeve tona. Sa i përket anëtarësimit të Kosovës në UNESCO, z. Reçica tha se UNESCO është diçka tjetër dhe se nuk duhet krahasuar me anëtarësim në Interpol. UNESCO nuk është vetëm çështje e trashëgimisë, por është çështje e arsimit, kulturës, shkencës dhe se Serbisë i ka penguar që shqiptarët të jenë të arsimuar, të kulturuar, të edukuar dhe të merren me shkencë njoftoi z. Reçica. Lidhur me angazhimin e Kuvendit në këtë çështje tha se deputetët kanë qasje në mekanizma që janë jashtë qeverisë, ku përmes diplomacisë parlamentare mund të kenë ndikim në ndonjë Parlament, shteti i të cilit nuk e ka njohur Kosovën dhe tek ato shtete ku Qeveria nuk ka mundur të krijoj kontakte.

**Vjosa Osmani- Sadriu** kërkoi që në takimin e radhës të grupit punues të përgatitët një listë me shtete ku Kuvendi i Kosovës mund të ndihmojë dhe t'i përcillet komisionit.

**Flamur Sefaj** tha se janë të hapur që komisioni të kontribuojë në grupin punues dhe se komisioni mund ta caktojë një deputet, i cili do të jetë anëtar i barabartë në këtë grup. Grupi punues tha se funksionon mirë dhe se në të duhet të përfshihen edhe përfaqësues nga Kuvendi, Presidenca dhe shoqëria civile. Duke iu referuar pyetjes së kryetares së komisionit se sa është optimist që Kosova do të anëtarësohet në Interpol, ministri tha se nuk mund të jap ndonjë përgjigje të saktë, mirëpo është shumë optimist dhe se janë duke punuar me një energji pozitive në këtë drejtim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetare e Komisionit,

---

Vjosa Osmani-Sadriu